

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mirëseerdhët në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Sekretari i këshillit bashkiak bën apelin. Marrin pjesë 39 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

*Pika e parë miratimi i rendit të ditës.*

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### ***Pika e dytë e rendit të ditës.***

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së muajit Dhjetor (dt.26.12.2023)

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Procesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 3 dhe 3/1 e rendit të ditës.*

*3. Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë Elbasan për muajin Dhjetor 2023.*

*3/1 Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2023.*

### **Aurora Domni- anëtare e Këshillit Bashkiak**

Është vetëm kjo vlera e shprehur në relacion?

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Po.

E hedhim në votim.

Këshilli Bashkiak me 38 vota pro, 1 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

V.o (Vota kundër Ergys Muzhaqi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 4 e rendit të ditës.*

*Për miratimin e dhënies me qera të ambjenteve në godinën e pallatit të sportit “Tomor Sinani” në lagjen “28 Nëntori,” nga Bashkia Elbasan.*

Ka ndonjë paqartësi?

### **Ergys Muzhaqi- anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Pse ndryshojnë çmimet? Një pjesë ishte 700 lekë, një pjesë 800 lekë.

### **Znj. Aulona Bylykbashi- nënkryetare e bashkisë**

Çmimet e dhënies me qera janë të përcaktuara me VKB, dhe janë sipas pozicionit, kështu që vetëm i referohemi VKB së miratuar, të cilën mund t’jua vëm në dispozicion. Nëse këshilli ka një nisëm për ndryshimin e tarifave për qeradhënie, mund ta nisni si nisëm, të ndryshojmë VKB dhe në bazë të asaj të ndryshojmë nivelin e qerasë, por sot për sot është një VKB e miratuar.

### **Altin Meçja- anëtarë i këshillit bashkiak**

Mbledhja duhet të jetë online. Është me rregullore.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ndjesë sepse mungon sot.

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro, - kundër, 3 abstenim, miraton sa më sipër.

V.o (Vota abstenim D. Madhi, E. Muzhaqi, A. Kana)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 5 e rendit të ditës.*

*Mbi dhënie në përdorim, pa kundërshpërblim të ambjentit zyrë tek ish-Godina e Partive Politike lagjia Partizani, P.S.D dega Elbasan nga Bashkia Elbasan.*

Këshilli Bashkiak me 38 vota pro, 1 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

V.o (Vota Kundër A. Marku)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 6 e rendit të ditës.*

*Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik “Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale, rikonstruksion i gjendjes ekzistuese të rrugës “Arif Dardha” nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”.*

### **Doris Madhi- anëtare e këshillit bashkiak**

Duke qënë se e diskutuam duhet të ketë një marrëveshje të shkruar. Pavarësisht se thatë se janë vet banorët që kanë diskutuar, që most ë përballemi nesër me problematika.

### **Znj. Aulona Bylykbashi- nënkryetare e bashkisë**

Referuar kësaj problematike ne e kemi sqaruar në komision. Ne kemi një dakortësi me banorët, e arritur dhe e diskutuar dhe me drejtuesit e Rajonit të cilët janë më afër problematikave të zonës ku do zhvillohet investimi. Ato e kanë kërkuar me ngulm. Duke qënë se erdhi mundësia nga bashkia dhe Ministria e financave në kuadër të projekteve të strehimit, ku futet dhe infrastuktura, dhe duke qënë se dosjet e shpronësimit marrin afate ligjore, i është siguruar banorëve se nuk do të cënohetasnjë e drejtë e tyre në rasport me sipërfaqet që preken dhe në procesverbalet e procesit. Çmimi nuk ndryshon pasi e përcakton VKM, është një llogaritje e thjeshtë e asaj çfarë ajo përfaqëson. Prandaj nuk është parë e nevojshme të marrim çdo banorë ta çojmë tek noteri, tyë bëjmë një marrëveshje noteriale, kështu që thjesht ka qënë lehtësuese për procesin, çdo gjë është në rregull, nuk kemi pretendime nga banorët, ndërkohë që kemi hedhur dhe fazën tjetër, kemi bërë korespodencën për të indetifikuar sipërfaqet që preken dhe menjëherë pas vendimit të Këshillit do të bëjmë hartimin e dosjes.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

E hedhim në votim.

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 7 e rendit të ditës.*

*Mbi miratimin e kontratës së “Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan” në impijantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë ECO-ELB sh.a midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë ECO-ELB sh.a.*

### **Bjanka Çopja- anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Përshëndetje, ju uroj një vit të mbarë dhe të marrim vendime sa më të mira. Në momentin e marrjes së rendit të ditës kjo ishte pika kryesore. Besoj se po na ftoni ta miratojmë dhe po na shisni një dështim si sukses. E them këtë pasi ne si anëtarë kemi bërë një kërkesë për informacion në datë 22.10.2023 drejtuar Bashkisë Elbasan. Pas kërkesës së dytë pak më vonë se kërkesa e parë pas dy muajve erdhi një përgjigje se bashkia nuk kishte informacion në lidhje me atë që ne kërkonim, më duket e habitshme që nuk ka informacion as si pronar as në cilësinë e klientit. Të kesh një përgjigje zyrtare të tillë do t’ua tregoj, thot se ECO ka vënë në dijeni bashkinë për defektet të cilat kanë çuar në fikjen e impijantit. Thoni nuk e kemi informacionin çfarë po ndodh. Në 2022 ka punuar vetëm 1 ditë, dhe 364 ditë të tjera të vitit është lënë. Në vitin 2023 ka punuar vetëm një muaj. Lind pyetja pse e ka marrë këtë tarifë Bashkia Elbasan, kur mund mos ja merrte, dhe kur ta keni në punë. Është një minë me sahat në Elbasan më atë malin pafund. Në vitin 2022 bashkia i ka paguar ECO-ELB ndërmjet thesarit në vlerën 55 milionë e 94 mijë e 800 e 10 lekë. Në total paguhen 90 milionë për një incinerator që nuk punon që mbledh vetm mbetje. Ajo që vjen në përgjigjen tuaj është një strukturë me 94 punonjës, ku pjesa më e madhe nga fondet kalojnë paga, është humbje. I bie që punon vetëm për paga. Pyetja tjetër që bashkia nuk e kishte për të dhënë përgjigje, është a ka pasur auditim për pagesat që shoqëria ka kryer në 2023? Këtu janë vetëm tender 124

milionë e 280 mijë vlerë. Tendera me flamur të kuq, klientelistë me një person që e merr. Për këtë arsye dhe shumë të tjera ftoj mos ta miratojmë të paktën dështimin për sukses.

### **Znj. Aulona Bylykbashi- nënkryetare e bashkisë**

Si përfaqësuese e bashkisë do të kisha një përgjigje shumë të gjatë, por para së gjithash dua të sqaroj se shkresa që ju keni dërguar, është në shkresë teknike. Shkresa teknike kërkon informacion për subjektin që e kryen këtë proces, dua të sqaroj në raport se çfarë funksioni kanë aksionerët dhe çfarë funksioni ka vet shoqëria, sepse për fat të mirë ligji i ndan funksionet. Është shoqëria që bën menaxhimin, duke qënë se pyetjet shtroheshin në raport me menaxhimin aksioneri ka informacion për menaxhimin e përgjithshëm dhe bashkia si aksionere patjetër ka informacion për inceneratorin por pyetjet që ju shtroni nuk mund të merrni nga bashkia por nga shoqëria, për këtë arsye është adresuar atje ku mund të merrte përgjigjem kryesore. Unë gjithmonë dëgjoj pse lekët merren, lekët merrën për të rregulluar shërbimet ashtu siç ligji e kërkon dhe në këtë rast unë nuk e di se çdo të ndodhte nëse mbetet ku do i depozitonim në ECO-ELB. Konstatimet tuaja në raport me sa ditë ka punuar për mua nuk është e vërtet, duhet të keni parasysh që është marr në fund të 2022, kështu që mund të jetë në përgjigjen zyrtare por ju duhet të keni informacionin kur e ka filluar menaxhimin. Në këto kushte këto të dhëna që ju i përdorni për të dal tek argumentet tuaja politike nuk qëndrojnë. Ajo që ne kemi sjell për të miratuar është kontrata e cila nuk ka asnjë ndryshim, pavarësisht se çmiment meelemnetët e punës që funksionon, janë rritur ndjeshëm dhe me të gjithë kërkesat e vazhdueshme që ka bërë dhe pse ka qënë në vështirësi financiare ku brenda futen dhe defektet, unë nuk njoh ndonjë kompani që gjatë punës i shfaqen defekte në makineri, patjetër do të ketë dhe defekte, e rëndësishme është që impjanti rregullohet dhe vendoset në punën e tij. Kështu që në këtë rast ne ju kemi sjell për miratim këtë kontratë e cila nuk ka asnjë ndryshim dhe ka të njëjtën tarifë, për efekt procesverbal, ne e kemi miratuar bashkë me ju në buxhet fondin për miratimin e mbejtje për të qënë transparent kemi sjellë edhe kontratën e operimit. Nuk ka ndonjë risi, ajo që ju do bëni në këtë rast me mosmiratimin është se do ti detyroni qytetarët ato mbetet që i heqin nga koshat e tyre do ti keni aty poshtë pallatit. Në perceptimin tuaj këto mbetje ti heqin nga shtëpia dhe i depozitojmë tek rruga, tek fusha apo lumi, ndërkohë që në ju ofrojmë miratimin e kësaj kontrate të depozitohen atje ku duhet.

### **Bjanka Çopja- anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Në përgjigje të kësaj nuk po ndodh asnjë nga ajo që thatë sepse në 2023 gjithë ato muaj nuk është punuar, në bazë të përgjigjes zyrtare.

### **Znj. Aulona Bylykbashi- nënkryetare e bashkisë**

Këto para nuk po shkojnë nëpër xhepa por po shkojnë në një mirëadministrim të mbetjeve urbane dhe tarifrat që paguhen janë nën kosto, nëse ju keni kaq interes një ditë të ftoni administratorin, tju sjelli analizat përkatëse që të kuptoni që analizat janë shumë të larta në krahasim me mbetjet që depoziojnë të gjitha bashkitë.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mendoj ta shtyjmë miratimin për mbledhjen tjetër.

### **Doris Madhi- anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Përpos diskutimit që bëme në komision, vërej sot që relacioni që është bërë mungojnë formalish dy firma, këto nuk kanë qënë present apo nuk janë dakord. Pronarët të aseteve të bashkisë janë të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak. Jemi ne që vendosim si do përdoren asetet dhe duhet të ruajmë mirëmenaxhimin e tyre. E thënë në këtë formë në këndvështrimin tim është shumë e thjeshtë për të qënë një kontratë kaq e madhe, pikat janë shumë bazike. Nuk duhet të jetë kryetari i bashkisë ai që merr përgjegjësinë. Duhet të ketë një pikë të veçantë e cila do të përcaktonte delegimin nga ana e Këshillit si firmëtar i kryetarit të bashkisë.

Këto janë përgjegjësitë e secilit nga ne, këtu flitet për kosto, flitet për menaxhim apo keqmenaxhim, a ka një analizë të kostove bashkia Elbasan, si palë e interesuar e kësaj kontrate ju nuk paskeni informacion për analizën e kostos, për situacionet, për faktin e rëndë që kjo shoqëri qenka me humb

je të thellë në bilancë. Është bazë që të kesh dijeni mbi palën, sepse jemi në bashkëpunim, ku është analiza e kostos, pse nuk na ofrohet një dokumentacion i plotë dhei qartë, por nuk kam asnjë përveç një kontrate që është si një kontratë qeraje shtëpie. Aq më tepër që nuk është vetëm impiant që do të mbeturina, supozohet që do prodhonte energji, sa ka prodhuar deri tani, pse nuk na ofrohet nga vet shoqëria, dhe meqë jemi në këtë sens a jeni dakord që të bëjmë një kërkesë dhe ta shikojmë këtë impiant, si komision auditimi të vini dhe ti shikoni këto dokumentacioni që nuk na i ofrojnë në lidhje me funksionalitetin

e tij nga ana monetare. Nuk firmosen kontratat me sy mbyll. Jetojmë të gjithë në këtë qytet, nuk mund të trajtohet askush me lehtësi fjalësh, kjo nëpse do miratohet, do miratohet sipas të gjitha kushteve të menaxhimit. Do ti merrni plehrat sepse keni për detyrë ti merrni dhe keni për detyrë që kjo kontratë të zbatohet në kushtet e kontrollit. Nëse nuk funksionon të vi një kompani tjetër. Është infantile e gjitha kjo, une e kuptoj që ju me forcë kartoni do ta kaloni por do sygjeroja të pajiseni me dokumentacion, dhe në një mbledhje të dytë të biem të gjithë dakord ta miratojmë, asnjë nga ne nuk ka interes të mbytemi. Sygjerorj të pajisemi me dokumentacion mbi llogaritjen e kostos, pse është 2500 lekë për ton. situacionet ndër vite, funksionalitetin e impiantit ndër vite, na thuhet zyrtarisht se sa energji ka prodhuar dhe gjendjen aktuale të gjendjes së inceneretorit, e përsëris nëse jeni dakord bëjmë një ditë vizitë atje. Të paktën nga ana jonë do jetë një këkresë, nëse na bashkoheni dhe ju jeni të mirëpritur.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë do bashkohesha me mendimin që këtë vendim ta lëmë për mbledhjen tjetër, edhe Bashkia të përgatisë disa informacione shtesë.

### **Znj. Aulona Bylykbashi- nënkryetare e bashkisë**

Bashkia e ka të gjithë informacionin e mundshëm, ka të gjithë analizën e kostos, kam thjesht një pyetje pse në komisione jeni dakord dhe nuk keni asnjë pretendim në raport me informacionin, në komisionet që organzion këshilli që janë faza paraprake e distutimeve të dokumentve që vinë në këshill të gjithë janë të qetë dhe dakord, kur vim këtu dhe jemi publik të gjithë kanë pretendime, megjithatë ajo që keni kërkuar është vetëm tonazhi.

### **Doris Madhi- anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kur unë fola për koston më the ECO Elb ka këkuar rritje dhe ne vendosëm të ishte e njëjta dhe unë u përgjigja që kësaj pyetje nuk i përgjigjemi kaq shkurt sepse duhet të kemi një analizë kostoje, ndodhta eco elb ka të drejtë ndoshta dhe ska, por pa analizë kostoje ne nuk mund të vendosim në mënyrë arbitrare çmimin për ton.

### **Znj. Aulona Bylykbashi- nënkryetare e bashkisë**

Herën tjetër jua vëm në dispozicion të gjitha, që të jemi të gjithë të qartë këto kërsesa që keni që doni ti bashkngjitet materialit na dërgoni një email tek sekretariati që ne të dim dhe të kemi dhe diçka tjetër përveç kostos.

**Iirjan Sadiku- anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Unë do të sygjeroja ta miratojmë si kontratë sepse biznesi nuk funksionon as si parti as si bashki, biznesi ka të tjera halle dhe të tjera probleme, në rast se fillojmë pengesa, vërtetë do të vi një ditë që ato plehra do ti gjejmë tek dera. Biznesi funksionon ndryshe, ne e kalojmë si kontratë dhe në vazhdimësi të kërkojmë sa herë të duam llogari, të detyrojmë bashkinë tna japi informacionin, në rast se kemi probleme ka instance të tjera. Por ne nuk mund ta lëm sepse duam të prodhojmë politikë. Sepse nuk i del kosto. Herën tjetër të vi dokumentacioni. Ne duhet ti krijojmë lehtësi biznesit.

**Doris Madhi- anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Cilit biznes?

**Iirjan Sadiku- anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Atij biznesi, për sa kohë atij nuk i dalin të ardhurat për ta përmbushur misionin.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

E lëmë miratimin për mbledhjen tjetër. Jeni dakord besoj.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 8 e rendit të ditës.*

*Miratimi i normave dhe kritereve, karburant për mjete motorike.*

### **Aurora Domni- anëtare e Këshillit Bashkiak**

Mos i paragjykoni këto debate si politike. Unë vura se mjetet e bashkisë, administrate gjanë 9. Të bëjmë rrogari naftë në muaj një automjet i bie që harxhon në muaj rreth 5 milionë lek, janë 9 dhe shuëm të tjera. Ndërkohë që në 2 milionë e 900 i kishim për familjet me ndihmë ekonomike. Ne nuk e ulim dot dorën tek këto automjete, i bie në muaj 4500 km, për një automjet. Faleminderit nuk e miratoj këtë.

### **Znj. Aulona Bylykbashi- nënkryetare e bashkisë**

Ajo që keni vënë re është e gabuar në fakt sepse normimi supozon të përcaktojë ndërmjet ekspertëve duke futur të gjithë elementët në llogaritje, si amortizimi dhe të gjitha bashkë, sesa është norma e harxhimit për një automjet, pjesa e litrave poshtë është një përlllogaritje e përafërt sesa mund të harxhoj ky mjet në bazë të funksioneve që kryen. Nuk është se këto mjete harxhojnë cdo muaj kaq, harxhimi vjen në bazë të urdhrave të punës dhe dokumentohet në bazë të lëvizjes, po i referohem pjesës së parë por është e njëjta llogjikë. Ka mjete që lëvizin çdo ditë Elbasan-Tiranë -Durrës që shoqërojnë Drejtorinë Juridike që merret me proçeset gjyqësore, pjesa e liortave ka të bëjë me sasinë maksimale të përlllogaritur afërsisht që mund të harxhoj ky mjet në bazë të funksionit që ka, por nuk është e thënë që harxhon aq, sepse i gjithë shpenzimi i naftës së bashkisë nuk është kaq, megjithatë nëse keni kurizoitet vëm në dispozicion sa e ka pas harxhimin një mjet.

### **Aurora Domni- anëtare e Këshillit Bashkiak**

Tek agjensia e shërbimeve publike nuk thoni se sa orë në ditë do punojë.

### **Znj. Aulona Bylykbashi- nënkryetare e bashkisë**

Prandaj po them që është normim, nëse ky mjeti punon kaq orë harxhon aq teknikisht, pastaj sesa realisht do harxhoj varet nga urdhat e punës dhe nga puna konkrete që do të kryej sepse do të shkoj të pastroj kanalën, kush janë proçeset sa rri në punë, pastaj llogaritet proçesi.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Keni sjellë në vëmendje ndihmën ekonomike, por keni parasysh se janë dy, nga fondi i bashkisë dhe nga fondi i kushtëzuar.

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 11 kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(V.o Vota abstenim D. Cepa)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 9 e rendit të ditës.*

*Mbi ndarjen e asetëve të Agjensisë së Shërbimeve Publike.*

### **Znj. Aulona Bylykbashi- nënkryetare e bashkisë**

Duke qënë se u krijua nga një agjensi që ishte e shërbimeve publike, agjencia e shërbimeve rurale dhe urbane, normalisht të gjitha asetet dhe magazine që ka pas kjo agjensi është ndarë në dy. Pjesa më e madhe është rakorduar sepse është një proces i gjatë, në këtë material është kryer ndarja dhe në muajt në vazhdim do futemi për të rregulluar diçka që mund të na ketë ngelur. Në moment të fundit është vënë re nuk ishte ndarë siç duhet diçka ndërmjet dy agjensive dhe janë hequr disa element.

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 10 e rendit të ditës.*

*Informacion për nxjerrje jashtë përdorimi për 2023.*

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 11 e rendit të ditës.*

*Informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të (aseteve shkollore) për vitin 2023.*

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri




Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.01.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

*Pika e 1 e rendit të ditës tek të ndryshme*

*Mbi miratimin në parim të kontratës midis Bashkisë Elbasan dhe SHAV-it Shoqatës për autonomivë vendore “Për zbatimin e procedurës së vlerësimit të vetqeverisjes vendore me mjedis të favorshëm biznesi” (BFC SEE)*

### **Altin Mecja- anëtarë i Këshillit Bashkiak**

Sqaroheni pak këtë.

### **Znj. Aulona Bylykbashi- nënkryetare e bashkisë**

Kjo është një marrëveshje bashkëpunimi e bërë me shoqatën e Autonomisë Vendore sipas titullit të përcaktuar, vjen në frymën e krijimit të një klime më të ngrohtë për biznesin. Ka për qëllim që shoqata e Autonomisë Vendore për krijimin e një database të plotë të biznesit dhe të luajë rolin e një këshilluesi në raport me bashkinë me të gjithë elementët. Kjo është pak a shumë, pjesëmarrja e bashkisë është në vlerën 4500 Euro për krijimin e këtij database dhe shoqata vjen në formën e një partneri i cili asiston me eksperiencën që ka në krijimin e këtij mjedisi të favorshëm.

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbledhja mbyllet në orën 11:00.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Elvi Çuni



Mbajtëse e Proçesverbalit

Livia Guri



Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

